

Tiranë, më 09/09/2025

KËRKESË

Kërkues: RENEW SHPK
Rruga "Themistokli Gërmenji", Nd.1, Tiranë, Shqipëri

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

Lënda: Kërkesë për regjistrimin e Kontratës për Vendosje Pengu mbi Kuotat Nr. 740 Rep. dhe Nr. 437 Kol. datë 19.03.2025 dhe për mosaplikimin e penalitetit për regjistrim

Baza Ligjore -Ligji Nr. 9723, datë 04.05.2007 "Për regjistrimin e Biznesit" (i ndryshuar), neni 43, 74

- Ligji Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" (i ndryshuar), Seksioni II dhe III

- Rregullore e ERE "Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 235 datë 26.11.2021 (referuar në vijim si Rregullorja e ERE Nr. 235), neni 5,6,7,8

Të nderuar,

Shoqëria "RENEW" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në datën 28/10/2020, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) M02228017S, me seli në adresën: Rruga "Themistokli Gërmenji", Nd. 1, Tiranë, Shqipëri (këtu e në vijim "Shoqëria"), ka depozituar në QKB aplikimin për regjistrimin e **Kontratës për Vendosje Pengu mbi Kuotat me Nr. 740 Rep. dhe Nr.437 Kol. datë 19.03.2025**, për vendosjen e pengut mbi kuotën e zotëruar nga ortaku shoqëria **ARC Sh.p.k.** dhe që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve të Shoqërisë ndaj "**PROCREDIT BANK**" SH.A.

Shoqëria është licencuar në **veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike** nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me vendndodhje në pasurinë Nr. 550/5, të llojit "Ranishte", në Zonën Kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, me kapacitet prodhues 2MW, me Vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë në Shqipëri (ERE) Nr. 68., datë 08.04.2025 (publikuar në website zyrtar të ERE). Referuar nenit 20 të Ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" (i ndryshuar) ERE: a) merr vendime, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të licencuarit që veprojnë nësektorin e energjisë elektrike; b) përcakton rregullat dhe kërkesat për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike;

Në bazë të akteve në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" (i ndryshuar) dhe më konkretisht Rregullores së ERE Nr. 235/2025 (publikuar në website zyrtar të ERE) **Shoqëria si subjekt i licencuar nga ERE duhet të marrë miratimin paraprak nga ERE për të vendosur peng mbi kuotat e saj.**

Rr. Themistokli Gërmenji, Nd. 1, Tiranë, Shqipëri

Pavarësisht datës së nënshkrimit, Kontrata për Vendosje Pengu mbi Kuotat hyn në fuqi me marrjen e autorizimit/miratimit paraprak nga ERE si institucion liçencues, në përputhje me Nenin 8 të Rregullores së ERE Nr. 235.

Pas plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm nga Shoqëria sipas nenit 5,6,7,8 të Rregullores së ERE Nr. 235, ERE ka dhënë autorizimin për vendosjen e pengut mbi kuotat e Shoqërisë në favor të **“PROCREDIT BANK” SH.A.**, me Vendimin e Bordit Nr. 199 datë 15.08.2025 (publikuar në faqen zyrtare të ERE në Gusht 2025, në pritje botimi në Fletoren Zyrtare).

Sipas Vendimit të Bordit të ERE, Nr. 199 datë 15.08.2025 Shoqëria “RENEW” sh.p.k, duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar **brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.** Pra siç shihet qartë regjistrimi në QKB i kontratës së pengut mbi kuotat është një kusht që duhet të plotësohet nga shoqëria **a posteriori** (pas miratimit për vendosjen e kuotave si peng nga ERE).

Bazuar në sa më sipër, Shoqëria kërkon:

- i. regjistrimin në Regjistrin Tregtar të Kontratës për Vendosje Pengu mbi Kuotat me Nr. 740 Rep. dhe Nr.437 Kol. datë 19.03.2025
- ii. mosaplikimin e penaltetit për regjistrimin e kësaj kontrate në QKB sipas nenit 74 pika 3 të Ligjit Nr. 9723., datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar duke konsideruar detyrimin ligjor për miratimin paraprak të kësaj kontrate nga ERE si institucion liçencues, Rregulloren e ERE Nr. 235, dhe Vendimin e Bordit të ERE Nr. 199. Datë 15.08.2025

Bashkëlidhur kësaj kërkesë Ju lutem gjeni:

- Vendimi i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë në Shqipëri (ERE) Nr. 68., datë 08.04.2025;
- Vendimin e Bordit Entit Rregullator të Energjisë në Shqipëri (ERE) Nr. 199 datë 15.08.2025;
- Rregullore e Entit Rregullator të Energjisë në Shqipëri (ERE) miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 235 datë 26.11.2021;

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.
Me respekt,

RENEW SHPK
Përfaqësuar nga
Znj. Ejona Shkurti
Administrator



Rr. Themistokli Gërmenji, Nd. 1, Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 199, Datë 15.08.2025

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË
SHOQËRISË “RENEW” SH.P.K. SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË
DETYRIMIT NDAJ “PROCREDIT BANK” SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16 të, ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.08.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2157/3 prot., datë 12.08.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “RENEW” sh.p.k. për dhënie autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie autorizimit për shoqërinë “RENEW” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria me shkresën nr. 2157 prot., datë 24.07.2025, ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për vendosjen e kuotave si mjet (barrë siguroese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Procredit Bank” sh.a.

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Kërkesa për Dokumentacion Plotësues

- Shoqëria “RENEW” sh.p.k është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE me shkresën nr. 2157/1 prot., datë 01.08.2025 i ka kërkuar shoqërisë të informojë nëse është nënshkruar ndonjë marrëveshje siguroese vijuese me bankën pas licencimit.

3. Dorëzimi i Dokumentacionit Plotësues

- Shoqëria me shkresën nr. 2157/2 prot., datë 06.08.2025 ka bërë me dije se nga data e licencimit nuk janë lidhur kontrata të tjera kredie apo garancie me “Procredit Bank” sh.a., apo institucione të tjera bankare/financiare. Nga ana tjetër informon se pritet ndërmarrja e hapave të tjerë tekniko-administrativë për operimin e centralit, paketa e garancive të tjera përveç pengut mbi kuotat, të cilat nuk janë formalizuar ende, ndaj citon se do të vazhdojë të informojë për çdo zhvillim të mëtejshëm në lidhje me marrëdhënien me këtë bankë si dhe hapat që do marrë në lidhje me ecurinë e projektit.

4. Përfundime dhe Kërkesa të tjera për Dhënien e Autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “RENEW” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:
- **Neni 5, pika 2** - Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e Rregullores.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- **Neni 5, pika 4** - Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.
- **Neni 5, pika 5** - Shoqëria ka bërë me dije që dokumentacioni shoqërues i kësaj procedure të ruhet konfidencialiteti dhe të mos jetë i hapur për publikun.

5. Plotësimi i Kërkesës sipas nenit 8:

- **Pika 1** - Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës sigurose, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave.
- **Pika 2** - Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:
 - **Gërma “a”** - Ekstrakti historik i regjistrit tregtar.
 - **Gërma “b”** - Vendimi i organeve drejtuese: Ka depozituar Vendimin e Asamblesë së Ortakut të vetëm të saj me nr. prot. ARC_2025_0301, datë 18.03.2025, me anë të të cilit është miratuar lënia peng e 100% të kuotave të shoqërisë “RENEW” sh.p.k., si garanci për garantimin e detyrimeve që rrjedhin nga kredia, në favor të bankës.

- **Gërma “c”** - Marrëveshjen përkatëse:

“Kontrata Kredie” me nr. 738 rep, nr. 435 kol, datë 19.03.2025 dhe nr. 739 rep, nr. 436 kol, datë 19.03.2025, nënshkruar ndërmjet “Procredit Bank” sh.a. (në cilësinë e kredithënësit) dhe shoqërisë “RENEW” sh.p.k. (në cilësinë e kredimarrësit), për qëllime të përmbushjes së projektit të parkut fotovoltaik me fuqi 2 MW, në njësinë administrative Topojë, Bashkia Fier. *Vlen të theksojmë se edhe pse kontratat e kredive janë firmosur në datë 19.03.2025, pra, përpara datës 08.04.2025, datë në të cilën kjo shoqëri është licencuar pranë ERE-s, nuk kanë të specifikuar në nenet e tyre në mënyrë ekspicite datën e hyrjes në fuqi, si e tillë në interpretim të nenin 2, pika 2.8 dhe nenin 3 këto kontrata konsiderohen të hynë në fuqi në datën 12.06.2025, datë në të cilën është marrë leja e ndërtimit për ndërtimin e projektit fotovoltaik.*

- **Pika 3** - Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e Vendosura për Dhënien e Autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “RENEW” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja e është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Në referencë të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2022, shoqëria është e detyruar të dorëzojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i reflektimit në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.
- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “RENEW” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Procredit Bank” sh.a. (sipas kontratave të kredive datë 19.03.2025).
2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “RENEW” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “RENEW” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.
4. Shoqëria “RENEW” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi.
6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “RENEW” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER EDLIRA R. TELHARAJ
ADRESA Rr. "ISMAIL QEMALI,
PALL. NR. 12, Kt. I - TIRANE"
TEL: 672072286

KONTRATË PENGU

(KONTRATË PENGU KUOTA TË SHOQËRISË)

Nr. repertori: 740

Nr. koleksioni: 437

Tirane më 19/03/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2025052800044027102



A2025052800044027102

**KONTRATË PER VENDOSJE PENGU
KUOTAT E SHOQERISE
RENEW SH.P.K.**

Sot, më datë 19 / 03 /2025, para meje Notere EDLIRA R. TELHARAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Rr. "ISMAIL QEMALI, PALL. NR. 12, Kt. I - TIRANE", u paraqit personalisht:

KREDIDHENES: **PROCREDIT BANK sh.a**, person juridik i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me nr. unik identifikimi te subjektit (NUIS) J91524011J, ne date 11.02.1999, me seli në Rruga "Dritan Hoxha", Tirane, liçensuar nga Banka e Shqipërisë me Liçensën Nr.12, datë 15/03/1999, e përfaqësuar nga Znj. Roza Shpëtim Dumani, lindur me datë 10.06.1991, me numër personal J15610011L, banuese në Rr. Don Bosko, Tirane, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar prej meje nëpërmjet letërnjoftimit me Nr. 039726215, lëshuar me datë 18.02.2025.

KREDIMARRES: **RENEW SHPK**, i regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit me numer unik identifikimi te subjektit (NUIS) M02228017S, me seli ne Tirane, Rruga "Themistokli Germenji", Nd.1, Tirane, Shqiperi, e përfaqësuar nga Znj. Ejona Shkurti, lindur me date 01.04.1991, mbajtes i letërnjoftimit me nr.034702939, lëshuar me date 30.08.2019.

PENG-LENESI: **Shoqëria ARC SHPK**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K81728025F, me adresë Tirane Tirane Rruga "Themistokli Germenji", Nd. 1, përfaqësuar nga administratori Z. Zenel Hysenbegasi, lindur me date 31.12.1979, mbajtes i letërnjoftimit me nr.034895788, lëshuar me date 10.10.2019, autorizuar sipas vendimit te asamblesë te shoqerise ARC SHPK nr. 0301 date 18 / 03 /2025.

Ne çdo rast qe ne kete kontrate fjala Kredimarres eshte perdorur ne shumes "Kredimarresit", do te thote Kredimarresi se bashku me Peng-Lenesit, të cilët mbi bazën e premtimeve reciproke dhe të dhënave të dokumentuara, bien dakord me kushtet si më poshtë vijon:

NDËRSA:

- (A) **ProCredit Bank sh.a**, në cilësinë e "Kredidhënësit" dhe **RENEW SHPK** në cilësinë e "Kredimarrësit" kanë firmosur Kontrata Kredie ne shumen totale prej **1,735,000 (njemilione e shtatëqind e tridhjetë e pesëmijë) Euro**.
- (B) Për të siguruar pagesën ndaj Kredidhënësit të të gjitha shumave sipas Kontratave te Kredive, ne përputhje me paragrafin (A), Kredimarresit kane rënë dakord te vendosin ne favor te Kredidhënësit peng të rradhes së parë dhe *pari-passu* 100% te kuotave te shoqerise RENEW SH.P.K në shumën prej jo më pak se **1,735,000 (njemilione e shtatëqind e tridhjetë e pesëmijë) Euro**.



A2025052800044027102

- (C) **Tani e tutje**, duke patur parasysh angazhimet e përbashkëta dhe marrëveshjet e përfshira këtu, dhe në Kontratat e kredive, është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 INTERPRETIMI

1.1 Përkufizime

Shprehjet me germa të mëdha do të kenë kuptimin e atribuar për to në Kontratat e mesiperme nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë kontratë. Për më tepër, në këtë kontratë shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

- (a) **"Peng"** ka kuptimin e atribuar për këtë shprehje në Pikën 2.1 në këtë dokument.
- (b) **"Detyrime të Siguruara"**, nënkupton të gjitha shumat e tanishme dhe të ardhshme, borxhet dhe detyrimet afarëdoqofshin (aktuale ose të ardhshme, të përbashkëta ose të vecuara dhe të përbashkëta dhe të vecuara) të pagueshme, që janë për tu paguar ose të shkaktuara nga Kredimarrësi/Debitori tek Kredidhënësi/Kreditori sipas ose në lidhje me Kontratat e kredive.

1.2 Pavlefshmëria e dispozitave

Secila nga dispozitat e përfshira në këtë kontratë është e vecantë dhe e ndashme, dhe një deklaratë pavlefshmërie ose jodetyruese e këtyre dispozitave ose e një pjese të tyre nga gjykata e juridiksionit kompetent nuk do të ndikojë vlefshmërinë ose detyrimin e ndonjë dispozite tjetër në këtë dokument.

1.3 Ndryshim, heqje dore

Asnjë ndryshim apo heqje dore nga kjo kontratë nuk do të jetë detyruese nëse nuk do të realizohet me shkrim nga pala e lidhur në këtë dokument. Asnjë heqje dore nga ndonjë dispozitë e kësaj kontrate nuk do të përbëjë heqje dore nga ndonjë dispozitë tjetër, as heqja dorë nga ndonjë dispozitë e kësaj kontrate nuk do të përbëjë një heqje dore të vazhdueshme, me përjashtim të rasteve kur shprehimisht parashikohet ndryshe në këto marrëveshje.

1.4 Afati

Kjo kontratë do të jete në fuqi për një afat të pacaktuar.

1.5 Ligji qeverisës

Kjo kontratë do të drejtohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë.

Neni 2 PENGU

- 2.1 Kredimarresit si një garanci për shlyerjen e e plote dhe të pakthyeshme të detyrimeve të garantuara me ane të këtij akti: - në mënyrë të pakthyeshme, deri në shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga kjo marrëveshje, japin peng Kuotat në favor të Kredidhënesit; - në mënyrë të pakthyeshme bien dakord për dhenien e krijimin e një pengu mbi kuotat e pjesëmarrjes në shoqëri dhe të drejtat e lidhura me to në favor të Kredidhënesit si dhe mbi çdo kuotë të re të shoqërisë ose të drejtat e lidhura me to që mund të zoterohen në të ardhmen nga Kredimarresit (Penglënesit);
- 2.2 Pengu ndaj Kredidhënesit jepet si garanci e rradhes së parë për dhe deri në përmbushjen e plote dhe të pakushtezuar të detyrimeve të siguruara.
- 2.3 Pengu ndaj Kredidhënesit nuk do të reduktohet në asnjë mënyrë për arsye të shlyerjes së pjesëshme të detyrimeve të garantuara.
- 2.4 Kredimarresi duhet të pajisë Kredidhënesin me vendimin e asamblesë së ortakëve që autorizon krijimin e pengut. Kjo kontratë depozitohet në Regjistrin Tregtar të Qendres Kombëtare të Biznesit.
- 2.5 Kredimarresit me ane të këtij akti autorizojnë Kredidhënesin të nënshkruaj, kompletoj, regjistroj, depozitoj të gjithë dokumentat e metejshme që Kredidhënesi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të realizuar qëllimin e kësaj kontrate, për të kompletuar e siguruar vazhdimësinë e pengut, për mbrojtjen dhe ruajtjen e kolateralit dhe ekzekutimin e të drejtave të Kredidhënesit sipas kësaj kontrate



A2025052800044027102

2.6 Me pengjet e mësipërme Kredidhënësi sigurohet për:

- a) shlyerjen e principalit, interesit, rinovimeve, përmirësimeve dhe modifikimeve të parashikuara në këtë Kontratë ose në shtesat e ndryshimet e kësaj Kontrate perfshire edhe plan pagesat per levrimet e ardhshme nese ka ;
- b) shlyerjen e të gjitha shpenzimeve dhe komisioneve të ngarkuara mbi të, për të mbrojtur dhe për të siguruar këtë mjet garancie;
- c) të gjitha kamatat, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit, si dhe shpenzimet e bëra nga Kredidhënësi për shlyerjen e Kredisë.

2.7 Kredimarrësit deklarojne, pranojne dhe garantojne Kredidhënësin (Bankën) se:

- a) Kuotat e shoqerise, janë në pronësi të Kredimarrësve ;
- b) do paguajnë shpenzimet e sigurimit të tyre në emër të Kredidhënësit përkundrejt humbjes ose dëmtimit nga një rrezik i mundshëm, duke dorëzuar periodikisht duplikatat ose çertifikatat origjinale të lëshuara për këtë qëllim;

2.8 Në rast se për një ose disa shkaqe, të justifikueshme ose të pajustificueshme Kredimarrësit jane në pamundësi për të shlyer, Kredidhënësi ka të drejtë (përveç të drejtave të tjera të pranuar në këtë Kontratë) në çdo kohë ose herë pas here, me ose pa proces gjyqësor, me ndihmën ose pa ndihmën e të tretëve, të marrë në zotërim pasurite e lëna peng dhe të kryejë vetë ose të kërkojë të kryhen nga organet kompetente veprimet e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit.

Neni 3

DETYRIMET E SIGURUARA

3.1 Detyrimet e siguruara

Pengu i ofruar siguron pagesën, performancën, dhe përmbushjen e gjithë Detyrimeve të Siguruara.

3.2 Interesi i vazhdueshëm

Pengu do të jetë një Garanci e vazhdueshme pavarësisht se detyrimet mund të jenë të luhatshme dhe të zvogëlohen në një vlerë më të vogël se shumën e bllokimit të kuotave me anë të kësaj marrëveshje.

3.3 Aplikimi i pagesave

Kuotat e ofruara peng do të përdoren për qëllimin e përmbushjes së detyrimeve që Kredimarrësi merr në zbatim të kësaj kontrate dhe kontratave të ekspozimeve **ne shumen prej 1,735,000 (njemilione e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë) Euro.**

Neni 4

REGJISTRIMI I PENGUT

4.1 Kredidhenësi/personat e autorizuar të Kredidhenësit do të dorëzojnë një Formular Njoftimi të Regjistrimit në përputhje me atë që është përshkruar nga Rregullorja mbi Barrat Siguruese ("Rregullorja") në Regjistrin Shqiptar të Barres Siguruese ("Regjistri") që do të hyjë në bazën e të dhënave të Regjistrit. Pas këtij regjistrimi leshohet një certifikatë, që konfirmon regjistrimin e Barres së Sigurimit në Regjistrin perkates te kolateralit. Kjo certifikatë leshohet në përputhje me Rregulloren e RBS, dhe në të pasqyrohen numri i regjistrimit, koha e regjistrimit, emri i Kredidhenësit dhe Kredimarrësit, përshkrimi i Kolateralit, si dhe kohëzgjatja e Barres së Sigurimit.

4.2 Kredimarrësi/ personat e autorizuar të Kredimarrësit do të depozitojnë pranë Qendres Kombetare të Biznesit një kerkese shoqeruar me një kopje të kësaj kontrate me qëllim regjistrimin e pengut. Një ekstrakt zyrtar nga dosja tregtare e Kredimarrësit që mbahet pranë Regjistrit Tregtar dhe provon regjistrimin e pengut, do të dërgohet Kredidhenësit menjëherë me realizimin e regjistrimit.

Pasi Kredimarrësi dhe Kredidhenësi të kenë marrë certifikatën e regjistrimit që pasqyron kontratën e lidhur nga palët këtu dhe ekstrakt zyrtar nga dosja tregtare e Kredimarrësit që provon regjistrimin e pengut, Barra e sigurimit do të konsiderohet e vendosur.



A2025052800044027102

Neni 5 DETYRIMET E KREDIMARRSIS

5.1 Detyrime të përgjithshme

Kredimarrsi bie dakord që:

- a) do të njoftojë Kredidhenesin menjëherë për
 - i. cdo ndryshim në emër dhe në pronësi të Kredimarrsis;
 - ii. cdo humbje të Kolateralit;
 - iii. ndodhjen e ndonjë Ngjarje Mospërmbushje detyrimi
- b) të mos ndryshojë kapitalin e regjistruar të shoqërisë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Kredidhënesit;
- c) nuk do të shesë, transferojë, ose ndryshojë tjetërsojë ose shkatërrojë pronësinë mbi Kolateralin ose ndonjë interesi të kësaj kontrate;
- d) do të njoftojë menjëherë Kredidhenesin për cdo pretendim ose kërkesë në lidhje me cdo pjesë të Kolateralit dhe për cdo ngjarje tjetër që ndikon mbi Kolateralin, i cili në secilin rast mund të parashikohet se mund të ketë një ndikim material negativ mbi vlefshmërinë ose detyrimin e Pengut të krijuar këtu ose mbi të drejtat ose zhdëmtimet e Kredidhënesit;
- e) në rast se ndryshon emrin, Kredimarrsi do t'i japë, para se ndryshimi i emrit të bëhet efektiv ligjërish, një njoftim me shkrim Kredidhënesit me emrin e ri dhe datën se kur do hyjë në fuqi ndryshimi i emrit; dhe
- f) do të bëjë, ekzekutojë, pranojë, dhe dorëzojë këtë formular njoftimi të regjistrimit dhe caktime të tjera, transferime, dokumentacione, veprime, çështje dhe fakte të tjera sic mund të kërkojë nga Kredidhenesi për të bërë efektive këtë kontratë;
- g) angazhimi i Kontratës së ktedise do të aplikohet gjithashtu tek kjo Kontratë e Pengut.

5.2 Verifikimi i kolateralit

Kredidhenesi do të ketë të drejtën në cdo kohë dhe herë pas here të verifikojë ekzistencën dhe statusin e kolateralit në cdo mënyrë që Kredidhenesi mund të konsiderojë si të pershtatshme dhe Kredimarrsi bie dakord të ofrojë gjithë mbështetjen dhe informacionin dhe të performojë gjithë këto veprime ose këtë qëllim për ti dhënë akses Kredidhënesit ose përfaqësuesve të tij të autorizuar në gjithë dokumentacionin që i përket kolateralit të ofruar nga Kredimarrsi.

5.3 Shpenzime

Kredimarrsit do t'i paguajnë Kredidhënesit me kërkesë, gjithë kostot e arsyeshme të Kredidhënesit, tarifave, dhe shpenzimet e dëshmuara me prova duke përfshirë, pa asnjë kufizim tarifave ligjore në lidhje me krijimin, regjistrimin, përfundimin ose ruajtjen e Barres Siguruese, detyrimin me cdo mjet të cdo dispozite këtu ose ushtrimit të të drejtave, fuqive, ose zhdëmtimeve në këtë dokument ose në përputhje me ligjin për Barrat e Sigurimit.

Neni 6 MBLEDHJA E KOLATERALIT NGA KREDIDHENESI

6.1 Mbledhja e kolateralit

Gjate ose pas ndodhjes së një ngjarje mospërmbushjeje, Barra e Sigurimit do të bëhet, sipas dëshirës së Kredidhënesit, menjëherë e zbatueshme dhe ai autorizohet në mënyrë të pakthyeshme pa njoftim paraprak të Kredimarrsis dhe pa kërkesë tjetër, në varësi të ligjit në fuqi, të zbatojë të gjitha të drejtat e Kredidhëneist dhe mund të aplikojë cdo formë marrje të pengut për përmbushjen e detyrimit të siguruar nga barra e sigurimit pas zbritjes së shpenzimeve të arsyeshme të mbledhjes.



A2025052800044027102

Neni 7
TË PËRGJITHSHME


7.1 Komunikim

Kurdoherë që ndonjëres palë këtu t'i kërkohet ose të ketë të drejtën të njoftojë ose adresojë palën tjetër ose të bëjë një kërkesë mbi palën tjetër, ky njoftim, adresim, kërkesë do të bëhet në formë të shkruar dhe do ti jepet, nëse dorëzohet fizikisht, vetëm palës të cilës i drejtohet ose mund të dërgohet me email i adresuar për palën të cilës i drejtohet në adresën e kësaj pale sic është përcaktuar më poshtë ose sic është ndryshuar, duke patur parasysh që ky ndryshim adrese ti dorëzohet palës tjetër në mënyrën e përcaktuar më sipër.

Kjo kontratë, pasi iu lexua me ze te larte e te qarte paleve dhe ato e gjeten permbajtjen e saj ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, nenshkruhet rregullisht prej tyre para meje Noterit dhe une Noteri vertetoj sa me siper ne baze te ligjit Nr. 110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine" ne Republiken e Shqiperise.

KREDIDHENES

ProCredit Bank sh.a,
Perfaqesuar nga:


Emer Mbiemer Firme



KREDIMARRES

RENEW SHPK
Perfaqesuar nga:
EJONA SHKURTI



Emer Mbiemer Firme

PENG-LENESI

ARC SHPK
Perfaqesuar nga:
ZENEL HYSENBEGASI


Emer Mbiemer Firme

NOTER


NOTER



Shoqëria: ARC SH.P.K

Adresë : Tiranë Rruga "Themistokli Gërmenji", Nd. 1

Telefon: +355692607544

NUIS: K81728025F



Nr. Prot. ARC_2025_0301

VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKUT TE VETEM TË SHOQËRISË

"ARC" SH.P.K

ME NUIS: K81728025F

Sot më datë 18/03/2025, në selinë e Shoqërisë "ARC" sh.p.k, me NIPT **K81728025F**, e regjistruar ne Qendrën Kombëtare të Biznesit, u mbledh Asambleja e Ortakut të Vetëm me prezencë të 100 % të kuotave të Shoqërisë të zotëruara nga:

Z.Besnik Leskaj, atësia Astrit, amësia Valentina, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, lindur më 30/06/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID Nr. 033356215 dhe Nr. Personal H60630112W.

RENDI I DITËS

Shoqëria "ARC" sh.p.k, me prezencë të 100 % të kuotave të Shoqërisë, bazuar në Statutin e Shoqërisë si dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" – i ndryshuar dhe duke zbatuar me përpikmëri Statutin e Shoqërisë "ARC" sh.p.k, deklaroi të thirrur këtë mbledhje për të diskutuar dhe vendosur sa më poshtë:

1. Diskutimin për miratimin e lënies si garanci në favor të Bankës "PROCREDIT BANK" sh.a , të 100% të kuotave të Shoqërisë "RENEW" shpk me NUIS M02228017S, për garantimin e detyrimeve të Shoqërisë "RENEW" shpk që ka ndaj Bankës "PROCREDIT BANK" sh.a, në shumën limit 1.735.000 Euro.
2. Autorizimin e Z.Zenel Hysenbegasi, mbajtës i Nr.Personal H91231047K, për të marrë pjesë në Vendimin e Asamblesë së Shoqërisë "REBEW" sh.p.k, për të firmosur Kontratën për vendosjen e pengut mbi kuotat e Shoqërisë "RENEW" shpk si dhe të gjitha aktet e nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij vendimi.

Asambleja e Ortakut të Shoqërisë "ARC" sh.p.k, me prezencë të 100% të kuotave të Shoqërisë, në përputhje me Ligjin " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe duke zbatuar me përpikmëri Statutin e Shoqërisë "ARC" sh.p.k, në unanimitet:

VENDOSI:

1. Miratimi për lënien si garanci në favor të Bankës "PROCREDIT BANK" sh.a , të 100% të kuotave të Shoqërisë "RENEW" shpk me NUIS M02228017S, për garantimin e detyrimeve të Shoqërisë "RENEW" shpk që ka pranë Bankës "PROCREDIT BANK" sh.a, në shumën limit 1.735.000 Euro.
2. Autorizimin e Z.Zenel Hysenbegasi, mbajtës i Nr.Personal H91231047K, për të marrë pjesë në Vendimin e Asamblesë së Shoqërisë "REBEW" sh.p.k, për të firmosur Kontratën për vendosjen e pengut mbi kuotat e Shoqërisë "RENEW" shpk si dhe të gjitha aktet e nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është i vlefshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies me Bankën "PROCREDIT BANK" sh.a.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "ARC" SH.P.K.

Z. BESNIK LESKAJ

Besnik Leskaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ARDJANA A. MEDIU



V2025050620097235314

DATE 19/03/2025
NR REP 1467

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 19.03.2025, para meje Notere Ardjana A. Mediu, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tirane, Rruga 'Ismail Qemali', Pall Nr.11, Kati Nr.2, 1010,u paraqit personalisht:

NËNSHKRUESI:

Z.Besnik Leskaj, atësia Astrit, amësia Valentina, shtetas shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, lindur më 30/06/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 033356215 dhe Nr. Personal H60630112W.

Është në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Vendimin e Asamblesë të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "ARC" sh.p.k, të marrë më datë 18.03.2025", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

Ardjana A. Mediu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 68, Datë 08.04.2025

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “RENEW” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET PRODHUES 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1452/1prot., datë 04.04.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “RENEW” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “RENEW” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1159 prot., datë 18.02.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 52, datë 03.03.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 04.03.2025 dhe 05.03.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 13.03.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 1159/4 prot., datë 06.03.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e ERE-s, me qëllim sqarimin e informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 1159/5 prot., datë 06.03.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, si dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore në ERE me qëllim marrjen e sqarimit/qëndrimit përkatës të MIE-s në lidhje me zbatimin e detyrimeve të shoqërisë për sa i përket afateve të ndërtimit/vënies në punë të centralit dhe/ose të vlefshmërisë së kontratës.
- Në seancën e zhvilluar në datën 13.03.2025 u paraqit vetëm përfaqësuesja e shoqërisë dhe nuk u paraqitën përfaqësues të MIE-s. Në vijim të sqarimeve të dhëna në seancë nga ana e përfaqësueses së shoqërisë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1159/6 prot., datë 13.03.2025, është depozituar dokumentacion shtesë.
- ERE me e-mailin nr. 1159/7 prot., datë 26.03.2025, i ka kërkuar shoqërisë që të depozitojë në ERE njoftimin/korrespondencën përkatëse me MIE-n, në lidhje me mungesën e faqes 10 të kontratës së nënshkruar me të.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1159/8 prot., datë 26.03.2025, nga shoqëria është bërë me dije se pas kërkesës së bërë pranë MIE-s, në arkivën e saj është gjendur kontrata e plotë, ndaj një kopje e plotë e kontratës është depozituar në ERE.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se:

Paisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n, kontratën nr. 2426 rep., nr. 1571 kol, datë 28.04.2023 “*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në Zonën Kadastrale 3358, Njësia Administrative topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier*”, nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë “RENEW” sh.p.k.
- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a., nr. 5592/3 prot., datë 06.09.2024.
- Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më 17.07.2024, për ndërtimin e impiantit fotovoltaike me fuqi 2 MW.

Kushtet dhe Afatet Ligjore:

- Kontrata e nënshkruar me MIE-n me nr. 2426 rep., nr. 1571 kol., datë 28.04.2023, parashikon një afat 49-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.
- Bazuar në nenin 38, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, i ndryshuar, afati i vlefshmërisë së licencave për veprimtaritë e prodhimit, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet.
- Bazuar në nenin 9, pikën 1.2, gërmën “c” të Rregullores së licencimit, shoqëria duhet të përditësojë në ERE informacionin mbi strukturën organizative të shoqërisë, e cila duhet të

përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar. Shoqëria ka depozituar në ERE strukturën organizative, në të cilën aktualisht rezultojnë: Asambleja e Përgjithshme, e përbërë nga Ortaku i vetëm dhe Administratori. Bashkëpunëtori i vetëm i jashtëm i saj në këtë fazë është shoqëria “Kirac Green Energy” sh.p.k., me të cilën ka lidhur “Kontratë për Ndërtimin e Centralit Gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet Prodhues 2MW, Topojë, Fier” datë 10.01.2024, të cilën e ka depozituar në ERE. Në nenin 3 të kësaj kontrate përcaktohet kontraktori (shoqëria “Kirac Green Energy” sh.p.k.) që do të kryejë të gjitha punimet, duke fillur nga projektimi, furnizimi i materialeve, ndërtimi, instalimi, testimi, kolaudimi vënia në punë, si dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Gjithashtu, shoqëria ka sqaruar se pas pajisjes me licencë nga ERE, organigrama e saj do të jetë si vijon: Administratori, Sekretaria, Financa, Departamenti Teknik, Departamenti Juridik.

Në referencë të përcaktimeve të këtij neni, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht për të përditësuar informacionin mbi organigramën e saj me stafin teknik për kryerjen e veprimtarisë së licencimit.

- VNM është e vlefshme deri më datë 17.07.2026, por duke qenë se shoqëria parashikon të vendosë në operim centralin brenda muajit shtator 2025, vlerësohet që t’i lihet kusht që të raportojë në ERE fillimin e punimeve brenda datës 31.08.2025. Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, të dokumentacionit të depozituar në ERE në kuadër të këtij aplikimi, si dhe të parashikimit të bërë nga ana e saj, shoqëria parashikon të vendosë në operim centralin brenda datës 30.09.2025.
- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 ditë nga ky moment, shoqëria duhet të dorëzojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.
- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të vendimit në rast se nga ana e MIE-së depozitohet ndonjë qëndrim i ndryshëm në lidhje me vlefshmërinë e kontratës.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “RENEW” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
2. Shoqëria duhet të raportojë në ERE në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit brenda datës 31.08.2025.

3. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.09.2025.
4. Me fillimin e operimit, Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e fillimit të operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës si dhe duhet të përditësojë në ERE informacionin mbi strukturën organizative të shoqërisë, e cila duhet të përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar.
5. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi.
6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “RENEW” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

RREGULLORE

**PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
NDRYSHIMIN E STATUSIT LIGJOR TË TË LICENCUARIT, NDRYSHIMIN E
ORTAKUT/AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E TË LICENCUARIT DHE
VENDOSJEN E KUOTAVE/AKSIONEVE TË ORTAKUT/AKSIONARIT QË
KONTROLLON INTERESAT E TË LICENCUARIT SI MJETE PËR GARANTIMIN E
PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT/EVE NDAJ TË TRETËVE**

**PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet në përputhje me nenin 20, germa “g” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miraturar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe kushtet e licencave përkatëse për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurën, dokumentacionin e kërkuar dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për të licencuarit, që paraqesin kërkesën për:

- a) ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit;
- b) ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;
- c) vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortaku/aksionari që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore do të zbatohet për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët paraqesin kërkesën, për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore, frazat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a) “Ligji për energjinë” është ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.
- b) “Ligji për gazin natyror” është ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.
- c) “Bordi i ERE-s” është organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.
- d) “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.
- e) “Licencë” është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në përputhje me dispozitat e ligjit të energjisë dhe ligjit të gazit natyror.
- f) “I licencuar” është një person i cili gëzon të drejtën dhe është i pajisur me licencë për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike apo të gazit natyror, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.
- g) “Procedurë” është tërësia e veprimeve, që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi.
- h) “Transferim kuotash/aksionesh” është çdo veprim me anë të të cilit krijohet një marrëdhënieje shitjeje, dhurimi, dhënieje me qira, transferimi, hipotekimi, barre ose çfarëdolloj disponimi tjetër i kuotave apo aksioneve të të licencuarit, kur nga ky transferim ndryshon ortakut/aksionari që kontrollon interesat e të licencuarit.
- i) “Ortakut/aksionari që kontrollon interesat e të licencuarit” është ortakut apo aksionari që zotëron përqindjen e nevojshme për të përcaktuar vendimmarrjen në shoqërinë e licencuar. Për çfarëdolloj transferimi kuotash apo aksionesh që ndryshon këtë përqindje është e nevojshme të merret autorizimi nga ERE.

PJESA E DYTË
PROCEDURAT E PARAQITJES SË NJË KËRKESË PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT
NGA ERE

Neni 5

Paraqitja e kërkesës

1. Procedura për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, fillon me paraqitjen nga një i licencuar i kërkesës për një ose disa nga rastet e mëposhtme:
 - a) ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit;
 - b) ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;
 - c) vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortaku/aksionari që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar.
2. Kërkesa dhe informacioni bashkëlidhur kërkesës duhet të jenë nënshkruar nga personi ose personat që kanë kompetencën për përfaqësimin e të licencuarit.
3. I licencuari mund të caktojë dhe një përfaqësues ligjor për të paraqitur në ERE aplikimin, së bashku me dokumentacionin përkatës, dhe për të ndjekur procedurën deri në dhënie e autorizimit nga ERE për transferimin, sipas kërkesës. Në këtë rast duhet të paraqitet në ERE prokura ose autorizimi i dhënë nga i licencuari për përfaqësimin e tij.
4. Dokumentacioni i paraqitur nga i licencuari duhet të jetë në gjuhën shqipe, original, fotokopje e noterizuar, ose me vulë elektronike. Dokumentet dhe deklaratat nga organet e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së kërkesës. I gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të depozitohet dhe në një kopje elektronike (CD ose USB).
5. Pjesët e dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim duhet të specifikohen në kërkesë, së bashku me arsyet e mosbërjes publike të tyre. Përndryshe konsiderohet se kërkuesi nuk e kërkon një kufizim të tillë.

Neni 6

Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm, për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit

1. Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor, duhet përfshijë në kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin/dokumentacionin si më poshtë:
 - a) emrin e plotë të të licencuarit;
 - b) adresën e saktë të të licencuarit ose/dhe personit të autorizuar për të ndjekur këtë procedurë në ERE, ku të përfshihet edhe numri i telefonit dhe adresa e *e-mailit*;
 - c) një përshkrim nga i licencuari mbi arsyet e ndryshimit të statusit ligjor, duke përcaktuar dhe afatin e këtij ndryshimi;
 - d) ekstraktin historik të regjistrit tregtar të të licencuarit.
2. I licencuari duhet të ketë shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Neni 7

Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit

1. Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit duhet të përfshijë në kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin si më poshtë:
 - a) emrin e plotë të të licencuarit;
 - b) adresën e saktë të të licencuarit ose/dhe personit të autorizuar për të ndjekur këtë procedurë në ERE, ku të përfshihet edhe numri i telefonit dhe adresa e *e-mailit*;
 - c) një përshkrim nga i licencuari mbi arsyet e ndryshimit të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit;
 - d) efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar;
 - e) një përshkrim të kandidatit të propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë (në rastin kur kontrollues i interesave të të licencuarit bëhet një person juridik/fizik);
 - f) informacion të detajuar mbi kontributin financiar që do të japë në ushtrimin e aktivitetit kandidati i propozuar për të kontrolluar interesat e të licencuarit;
 - g) deklaratë nga i licencuari se kuotat/aksionet për të cilat kërkohet transferimi nuk janë vendosur si mjete për garantimin e ndonjë detyrimi ndaj të tretëve.

Miraturar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

2. Bashkëlidhur kërkesës, përveç informacionit sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitohet në ERE dhe dokumentacioni si vijon:
 - a) ekstrakti historik i regjistrit tregtar të të licencuarit, si dhe ekstraktet historike të regjistrit tregtar të të gjithë ortakëve/aksionarëve të të licencuarit, në rastet kur këta janë persona juridikë/fizikë;
 - b) ekstrakti historik i regjistrit tregtar të kandidatit të propozuar për kontrollin e interesave të shoqërisë, në rastet kur ky është një person juridik/fizik. Në rastet kur kontrollues i interesave të të licencuarit do të bëhet një shoqëri e huaj, duhet të depozitohet ekstrakti me të dhënat tregtare përkatëse të regjistruara për këtë shoqëri, i përkthyer, i pajisur me vulë apostile dhe vërtetim përkthimi;
 - c) vendimi i organeve drejtuese të të licencuarit për kryerjen e transferimit të kuotave/aksioneve, transferim i cili ndryshon dhe ortakun/aksionarin që kontrollon interesat e të licencuarit, si dhe të organeve përkatëse drejtuese të ortakëve/aksionarëve të të licencuarit, në rastet kur këta janë persona juridikë/fizikë;
 - ç) vendimi i organeve drejtuese të shoqërisë tek e cila do të kryhet transferimi, ku të shprehet pranimi i këtij transferimi. Në rastet kur transferimi do të kryhet te një ortak individ, miratimi me shkrim i këtij të fundit për pranimin e transferimit. Në të dyja rastet duhet të shprehet dhe gatishmëria e kandidatit tek i cili do të bëhet transferimi për të vazhduar veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;
 - d) marrëveshje paraprake për transferimin e kuotave, nëse ka;
 - e) miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror përgjegjës, për transferimin e kërkuar, nëse kjo kërkohet nga aktet e autoritetit shtetëror;
 - f) vendimin gjyqësor të formës së prerë (në rast se ka), ku është vendosur ndryshimi i ortakut/aksionarit kryesor të të licencuarit.
3. I licencuari duhet të ketë shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Neni 8

Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm, për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër)

1. Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortakut/aksionari që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar, duhet të përfshijë në kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin si më poshtë:
 - a) emrin e plotë të të licencuarit;

Miraturar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

- b) adresën e saktë të të licencuarit ose/dhe personit të autorizuar për të ndjekur këtë procedurë në ERE, ku të përfshihet edhe numri i telefonit dhe adresa e e-mailit;
 - c) një përshkrim nga i licencuari mbi arsyet vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve;
 - d) një përshkrim të detyrimeve me të cilat ngarkohet i licencuari dhe pasojat në rast të moszekutimit të detyrimit sipas afateve dhe përcaktimeve të përshkruara në marrëveshjen paraprake;
 - e) deklaratë nga i licencuari se kuotat/aksionet për të cilat kërkohet transferimi nuk janë vendosur si mjete për garantimin e ndonjë detyrimi tjetër ndaj të tretëve.
2. Bashkëlidhur kërkesës, përveç informacionit sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitohet në ERE dhe dokumentacioni si vijon:
- a) ekstrakti historik i regjistrit tregtar të të licencuarit;
 - b) vendimi i organeve drejtuese të të licencuarit vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve;
 - c) marrëveshje paraprake e nënshkruar me bankën;
 - d) miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror përgjegjës, për transferimin e kërkuar, nëse kjo kërkohet nga aktet e autoritetit shtetëror;
 - e) vendimin gjyqësor të formës së prerë (në rast se ka), për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve.
3. I licencuari duhet të ketë shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Neni 9

Shqyrtimi i aplikimit

- 1. Shqyrtimi i aplikimit për dhënien e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, do të bëhet brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e tij.
- 2. Në çdo rast, por jo më vonë se 10 ditë pune nga paraqitja e kërkesës, ERE mund t'i kërkojë aplikuesit të plotësojë dokumentacionin e konstatuar të munguar nga aplikimi ose depozitim të informacionit shtesë brenda 10 ditëve pune nga marrja dijeni e mungesës së dokumentacionit/informacionit në aplikimin e tij.
- 3. Në rast se nuk plotëson dokumentacionin/informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, kërkesa e të licencuarit për dhënien e autorizimit nga ERE quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet kërkuarit bashkë me aktet e tjera.

Miraturar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

4. Në rast se dokumentacioni i kërkuar nuk është dërguar sipas kërkesave të nenit 6, 7 apo 8 të kësaj rregulloreje, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni fillon nga dita e depozitimit të dokumentacionit/informacionit të plotë nga kërkuesi.
5. Pas analizës përfundimtare të dokumentacionit të depozituar sipas përcaktimeve dhe afateve të kësaj rregulloreje, struktura përgjegjëse i paraqet Bordit një relacion, duke propozuar dhënien ose jo të autorizimit nga ERE, të shoqëruar me arsyetimet përkatëse, në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.
6. Në rast refuzimi të kërkesës, ERE do të njoftojë aplikuesin lidhur me arsyet e refuzimit dhe duke i dhënë udhëzimet e nevojshme brenda 7 ditëve pune nga marrja e vendimit.
7. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.
8. Në rastet e dhënies së autorizimit nga ana e ERE-s për ndryshimin e statusit ligjor apo transferimin e kuotave, i licencuari duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së, ku të reflektohet ky ndryshim/transferim.

Neni 10

Vendimmarrja e Bordit

1. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje, Bordi i ERE-s do të marrë vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, duke e bazuar vendimin e tij në:
 - a) plotësimin dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur në përputhje me sa përcakton kjo rregullore ose/dhe kërkesat për informacion/dokumentacion shtesë të ERE-s;
 - b) relacionin e hartuar nga personi/personat e ngarkuar nga struktura përgjegjëse;
 - c) efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të aktivitetit të licencuar;
 - d) gatishmërinë e kandidatit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi për të vazhduar veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;
 - e) gjendjen financiare të kandidatit të propozuar për transferim për të vazhduar me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.

Miraturar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

2. Bordi mund të japë dhe një vendim me kusht, rast pas rasti, në përputhje me specifikat e aplikimit, duke përcaktuar dhe një afat kohor për plotësimin e këtij kushti.

Neni 11

Njoftimi i vendimit

1. Në përfundim të procedurës për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, ERE do të njoftojë të licencuarin sipas përcaktimeve të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.
2. Për këtë vendimmarrje do të njoftohet dhe autoriteti shtetëror përgjegjës në rastin e dhënies së autorizimit nga ERE për një subjekt koncesionar apo që ka një autorizim nga autoriteti shtetëror përgjegjës.
3. Vendimi i ERE-s, i dhënë sipas kësaj rregulloreje, botohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
4. Kundër vendimit të Bordit të ERE-s, për miratimin apo refuzimin e kërkesës për dhënien e autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare, për subjektet e licencuara në një nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike, dhe brenda 45 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare, për subjektet e licencuara në një nga veprimtaritë e sektorit të gazit natyror

Neni 12

E drejta për t’u informuar mbi përmbajtjen e regjistrit të autorizimeve të dhëna nga ERE

1. ERE publikon në faqen e saj zyrtare të internetit regjistrin e autorizimeve, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Në këtë regjistër përfshihen të dhënat si më poshtë:
 - a) emri i të licencuarit;
 - b) NUIS-i (numri unik i identifikimit të subjektit);

Miraturar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

- c) numri dhe data e vendimit të Bordit të ERE-s për dhënien e autorizimit përkatës;
 - d) lloji i autorizimit të dhënë.
3. E drejta e aksesit në dosjen e dokumenteve shoqëruese u jepet personave me interes ligjor, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.
4. Informacioni konfidencial do të trajtohet në përputhje me përcaktimet e “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”.

PJESA E TRETË DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13 Ndryshime të rregullores

Kjo rregullore është objekt rishikimi me vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 14 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet nga Bordi i ERE-s dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.